



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1314/1 Prot.

Tiranë, më 04 / 09 / 2019

V E N D I M

Nr. 115 , Datë 04 / 09 / 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.70 Regj., datë 18.06.2019, e A. I dhe A. I¹, kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Fier, me pretendim diskriminimin për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, z/znj I janë motër e vëlla dhe që prej muajit Mars 2019 jetojnë në një banesë të përbashkët së bashku me dy fëmijët e tyre, njëri nga të cilët është me aftësi të kufizuar. Konkretisht O.N e cila është vajza e znj.A.I, referuar Raportit të KMCAPI Fier me nr.419 rezulton se përfiton të ardhura për invaliditet të grupit të II-të, pasi vuan nga sëmundja “Prapambetje mendore e moderuar”.

Ankuesit shprehen se prona e tyre ndodhet në vendin e quajtur “Vija e Ngjalës/Metalli”. Ata kanë ngritur pretendim se ndjehen të diskriminuar nga ana e OSHEE Fier, pasi prej muajsh jetojnë në errësirë të plotë, për shkak se atyre nuk iu është lidhur energjia elektrike edhe pse janë ankuar disa herë lidhur me këtë fakt.

¹ Në kontekst të cilësimit të ankuesit në kuptim të LMD, do të konsiderohen grup ankuesish.

² Referuar dokumentit të lëshuar nga KMSCP Fier, pranë DRSSH Fier, lidhur me personin O.N, e bija e subjektit ankues A.I.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën KMD.

Z.I citon se me datë 29.10.2018 ka aplikuar pranë OSHEE Fier për lidhje të re dhe lidhur me këtë fakt ka realizuar dhe pagesën përkatëse në shumën prej afro 30.000 lekësh, por që akoma dhe aktualisht ata vijnë të jenë pa energji elektrike, ndonëse në familjen e tyre ka një person me aftësi të kufizuar, të cilit i cënohen të drejtat më jetike dhe elementare.

Në përfundim të ankesës së tyre, ankuesit kërkojnë nga ana e OSHEE Fier të ndalë diskriminimin ndaj familjes së tyre dhe të marrë masat e nevojshme për të garantuar që atyre t'u realizohet furnizimi me energji elektrike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.974/1 prot., datë 20.06.2019 i është kërkuar informacion OSHEE Fier, lidhur me pretendimin e subjekteve ankues.

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Me shkresën me nr.1322/1 prot., datë 26.06.2019⁵ OSHEE Fier, ka dërguar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe ka informuar Komisionerin se: *“Lidhur me pretendimin e ankuesve mbi mosrealizimin e pikës së lidhjes së energjisë elektrike në objektin ku personat banojnë dhe diskriminimin e tyre nga ana e OSHEE Fier, sqarojmë se z.A. I është paraqitur pranë Zyrave të Kujdesit të Klientit Fier me datë 29.10.2018 dhe ka kryer aplikimin për pikë lidhje të re në objektin që disponon. Pas marrjes së kërkesës nga aplikuesi, në datën 09.11.2018 është kryer azhurnimi i kërkesës për pikë lidhje të re, sipas procesverbalit me nr.126153, datë 09.11.2018, ku ndër të tjera citohet se objekti ndodhet rreth 1200 metra nga pika më e afërt e lidhjes. Për këtë arsye abonenti është njoftuar nga ana jonë për kushtet e lidhjes sipas “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes OSHEE”, miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE-s, Ndryshuar me Vendimin nr. 177, datë 08.11.2018 të Bordit të ERE-s, ku në pikën 4.1 dhe 4.2, të saj “Tarifa të lidhjeve të reja” përcaktohen tarifat për lidhjen me rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike dhe shërbimet që do kryhen nga aplikanti, ku citohet se:*

Aplikanti do të kryejë:

- *Projektin për realizimin e lidhjes së re,*
- *Kryerjen e të gjitha punimeve me karakter ndërtimor dhe elektik (kabina, kanale, kablllo, pajisje komutuese, pajisje transformuese etj)*
- *Koston e pjesës së kabllit më shumë se 50 metra, vlera e të cilit do të përcaktohet referuar çmimit mesatar të këtij kablli në librat e OSHEE (klientë të pajisur me matës individual)”.*

OSHEE Fier vijon duke sqaruar se, z.I i është komunikuar kushti që duhet të plotësohet për kryerjen e lidhjes së re. Ndërkaq, referuar procesverbalit të sjellë nga OSHEE Fier, rezulton se me datë 24.01.2019 saktësohet distanca prej rreth 1000 metra e objektit të banimit të z./znj.I nga kabina dhe distanca prej rreth 600 metrash e pikës së lidhjes më të afërt.

Referuar akteve shkresore, rezulton se me datë 12.04.2019 është nxjerrë preventivi për kryerjen e pagesës për pikën e lidhjes në vlerën 30 166 lekë në Bankën Raiffeisen dhe në datë 17.04.2019 ka dalë raporti i bazës materiale për kryerjen e pikës së lidhjes së re të aplikuesit.

OSHEE Fier ka parashtruar faktin se: *“Grupi i punës, pas marrjes së bazës materiale e ka patur të pamundur instalimin e matësit për shkak të distancës së largët të lidhjes së energjisë”.* Ata janë shprehur se sapo abonenti të krijojë mundësinë e linjës elektrike, ata janë të gatshëm në çdo moment për të instaluar matësin e energjisë elektrike në banesën e tij.

2. Në zbatim të Urdhërit nr.139, date 09.08.2019 të Komisionerit, me datë 19.08.2019, pranë ambjenteve të OSHEE Fier, u realizua inspektimi i cili kishte si objekt të tij marrjen e informacionit drejtëpërdrejtë nga ky Operator, si dhe dokumentacionin shkresor përkatës.

Grupi i inspektimit të KMD-së u takua me z.E. M, me detyrë Specialist i Zyrës së Lidhjeve të Reja, pranë OSHEE Fier.

⁵ Protokolluar me Tonën me nr.974/2 prot., datë 28.06.2019.

Gjatë inspektimit u mor në cilësi prove dokumentacioni i kërkuar si dhe nga ana e z.E.M u parashtruan të njëjtat shpjegime sikurse në shkresën me nr.1322/1 prot., datë 26.06.2019 të OSHEE Fier, duke theksuar faktin se ata do të përpiqen të zgjidhin problematikën e z./znj.I dhe se do të njoftojnë në vijim Komisionerin lidhur me hapat e ndërmarrë prej tyre.

Me datë 28.08.2019, OSHEE Fier ka njoftuar Komisionerin se, problematika e subjekteve ankues z./znj.I është zgjidhur, duke mundësuar lidhjen e energjisë elektrike në banesën e tyre. Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga OSHEE Fier: procesverbal “Montim matësi për lidhje të re”, i datës 27.08.2019⁶ dhe foto të realizuara në terren, në banesën e subjekteve ankues, ky fakt rezulton i provuar.

Neni 33, pika 9 e LMD ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*.

Komisioneri vlerëson maksimalisht frymën bashkëpunuese me OSHEE Fier, lidhur me marrjen e masave të menjëhershme, për zgjidhjen e problematikës së subjekteve ankues, nisur dhe nga ndjeshmëria humane e faktit që kjo familje ka në përbërjen e saj një pjesëtar me aftësi të kufizuara.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin dhe kishte iniciuar ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nenit 90, pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur lidhur me shqyrtimin e ankesës së subjekteve ankues, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

⁶ Referuar këtij procesverballi provohet fakti i lidhjes së matësit të ri dhe furnizimit me energji elektrike të familjes I.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Aftësia e kufizuar